



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Nr. prot

Tiranë më 24.08.2026

NJOFTIM

PËR SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisve të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, vendimit nr .4, datë 02/03/2022 të Këshillit të Gjykatës, si dhe shkresës me nr.3013/1prot., datë 05.06.2024 të KLGJ-së, Gjykata e Lartë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- **2 (dy) vende vakante , pozicioni “ *Specialist*” në Qendrën e Dokumentacionit, (kategoria ekzekutive, IV-1).**

Pozicionet më sipër u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione , në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele , rezulton se ende ka pozicione vakante ,ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

07 shtator 2026

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

14 shtator 2026

Qendra e Dokumentacionit, e cila përbëhet nga dy sektorë, Sektorin e Publikimit dhe të Statistikave dhe Sektorin e Kërkimit Ligjor dhe Bibliotekës, është strukturë ndihmëse e ngritur pranë Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 35 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe përgjigjet kryesisht për:

- a) sigurimin e publikimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë
- c) publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë;
- ç) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare,
- d) përgatitjen e informacionit mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin specialist në Qendrën e Dokumentacionit përfshin por nuk kufizohet në detyrat e mëposhtme:

- Publikimin e vendimeve të Gjykatës në disa forma dhe mënyra: në Fletore Zyrtare, on-line në faqen web të GJL, në përmbledhje vendimesh në fund të vitit, apo përmbledhje tematike etj.
- Sigurimin e publikimit të ekstrakteve të vendimeve me rëndësi të veçantë, duke u kujdesur të paraqesë në mënyrë sintetike dhe të kuptueshme aspektet më thelbësore të vendimit.
- Publikimin e plotë në faqen zyrtare të institucionit të të gjitha vendimeve të Gjykatës sipas rendit kronologjik, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Përgatitjen e broshurës informative periodike mbi vendimmarrjen e Gjykatës dhe çështje të lidhura me të (newsletter), e cila i shpërndahet praktikantëve të së drejtës;
- Krijimin e një arkivi të vendimeve të Gjykatës sipas temave në një fushë të caktuar të së drejtës në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Gjykatës. Dokumentimi i vendimeve gjyqësore përfshin jo vetëm vendimet e Gjykatës së Lartë por edhe vendimet e gjykatave të zakonshme dhe të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me çështje të gjyqimit të zakonshëm në të gjitha nivelet.
- Përgatitjen e statistikave tematike periodike mbi vendimmarrjen e Gjykatës sipas kategorive dhe natyrës së çështjeve që janë përcaktuar nga gjyqtarët për këtë qëllim.
- Studimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe dhënien e mendimeve lidhur me qëndrimin dhe linjën e ndjekur nga Gjykata, për çështje të caktuara juridike gjatë procesit vendimmarrës të saj (praktikë e ndryshme e të njëjtit kolegji ose e trupave të ndryshme të të njëjtit kolegji);
- Kryerjen e kërkimeve mbi doktrinën dhe jurisprudencën në gjuhë të huaj në ndihmë të Kolegjeve të Gjykatës për çështje që kanë të bëjnë me njësimin e praktikës gjyqësore, si dhe të Kolegjeve të Bashkuara për çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimin e praktikës gjyqësore; o Përgatitjen e materialeve që i nevojiten Gjykatës së Lartë me rastin e organizimit të mbledhjeve, konferencave, vizitave studimore, apo për aktivitete të tjera brenda dhe jashtë vendit;
- Informimin e gjyqtarëve dhe këshilltarëve mbi praktikën gjyqësore vendase dhe të huaj për çështje që lidhen me juridiksionin e Gjykatës.
- Pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me literaturë bashkëkohore në formë të ndryshme (hard copy, e-library etj)
- Popullimin e platformës JUDIX me vendimmarrjet e Gjykatës së Lartë.

I. LËVIZJA PARALELE.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet e përgjithshme** për lëvizjen paralele si më poshtë:

- të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” ose “shumë mirë”.

Kërkesat e veçanta janë të njëjta për të dyja procedurat, lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil:

- Të jetë diplomuar në drejtësi ose fusha të tjera që janë në përputhje me pozicionin e punës, të paktën Diplomë “Master i Shkencave i Nivelit të Dytë” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
- Të ketë kryer studime pasuniversitare (me ose pa titull shkencor por të shoqëruar me vërtetim nga instituti arsimor përkatës);
- Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet si jurist, kryesisht si: lektor i së drejtës penale, civile, publike (administrative, kushtetuese, europiane), avokat, këshilltar ligjor ose specialist për kërkim ligjor, në sektorin publik ose privat.
- Të ketë aftësi dhe njohuri mbi metodat e kërkimit ligjor dhe të publikimit;
- Të ketë aftësi të shkrimit dhe analizës ligjore, si dhe të përgatitjes së memove ligjore;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze në nivel profesional (gjuha juridike), preferohet njohja në nivel profesional e një gjuhe të dytë (italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht);
- Të kenë njohuri teknike të nevojshme për përdorimin e sistemeve bazë të kërkimit online ose në platforma të tjera elektronike;
- Të kenë dëshirë dhe gatishmëri për të arritur nivele më të larta të profesionalizmit duke marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme dhe aktivitete që lidhen me aftësimin e mëtejshëm profesional;
- Të tregojë dëshirë dhe iniciativë për zbatimin e metodave bashkëkohore të punës me qëllim rritjen e efektivitetit të njësisë ku bën pjesë;

- Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët e sektorit por edhe me njësitë e tjera të Gjykatës, me qëllim realizimin e detyrave që i ngarkohen.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **07 shtator 2026**, pranë Gjykatës së Lartë ose në rrugë postare në adresën : *Rr. Ibrahim Rugova, Nr.10, 1001 Tiranë* dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurren.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës, (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument të gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi, numër kontakti dhe adresë elektronike.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e lëvizjes paralele për kategorinë ekzekutive do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë për fazat e mëtejshme të kësaj procedure të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), si më poshtë:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data e daljes së rezultateve do të jetë brenda datës **23.09.2026**.

Në përfundim të daljes së rezultateve të vlerësimit të kandidatëve, njoftimi me emrat e nëpunësve fitues do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së www.klgj.al dhe në faqen web të gjykatës, www.gjykataelarte.gov.al

Njoftimi dhe komunikimi për kandidatët do të jetë nëpërmjet adresës së e-mail të kandidatit.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës së Lartë duke filluar nga data **15.09.2026** për pozicionin specialist, në Qendrën e Dokumentacionit.

Ky informacion do të shpallet në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Marrëdhëniet me publikun-Vende vakante”.

II.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kandidatët për pranimin në shërbimin civil gjyqësor për të dy vendet e shpallura duhet të plotësojnë:

Kriteret e përgjithshme si më poshtë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit.

Kërkesat e veçanta janë të njëjta si për lëvizjen paralele (**shih më lartë**).

II.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **14.09.2026**, në ambientet e Gjykatës së Lartë ose nëpërmjet postës në adresën : *Gjykata e Lartë, Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë* dokumentet e mëposhtëm:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurren.
- CV e përditësuar
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës,
- Fotokopje të certifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Dokument që vërteton njohuritë e gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore ,
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vërtetim nga gjykata
- Vërtetim nga prokuroria

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraparak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi (provimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë)

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al duke filluar nga data **16.09.2026**. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës së Lartë individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidateve do të bëhet si më poshtë:

1. 60 pikë për rezultatet e testit me shkrim nga Komisioni i Pranimit;
2. 40 pikë nga Këshilli i Gjykatës:

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen janë:

- Organizimi dhe funksionimi i pushtetit gjyqësor;
- Natyra dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë;
- E drejta për informim mbi dokumentet zyrtare dhe Mbrojtja e të dhënave personale;
- Efektet e juridiksionit të gjykatave ndërkombëtare në të drejtën e brendshme.
- Llojet, natyra dhe fuqia e vendimeve gjyqësore.

KP brenda 24 (njëzet e katër) orëve, i njofton Këshillit listën e kandidatëve sipas pikëve, ose përfundimin e procedurës pa asnjë të kualifikuar.

Kandidatët e renditur në listën e kandidatëve, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e njoftimit.

Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh kandidatin për vendin e lirë përkatës, duke marrë parasysh kriteret sipas pikëzimit si vijon:

- a) renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim nga KP;
- b) 25 (njëzet e pesë) pikë për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë;
- c) 15 (pesëmbëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;

- b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data e daljes së rezultateve do të jetë brenda datës **30.09.2026**. Pas arsyetimit dhe publikimit të vendimit për rezultatet e procedurës së emërimit nga Këshilli, ky vendim do t'u njoftohet të gjithë kandidatëve. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin në faqen web të Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al dhe faqen zyrtare të KLGJ-së, www.klgj.al.

KËSHILLI I GJYKATËS GJYKATA E LARTË

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë